



REPUBLIKA E KOSOVËS
ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM

Nr. i Dokumentit: 22.6.1-2013-08

RAPORTI I AUDITIMIT
PËR PASQYRAT FINANCIARE TË KOMUNËS SË PEJËS PËR VITIN
E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2013

Prishtinë, Qershor 2014

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës. Auditori i Përgjithshëm, Lage Olofsson, është kreu i ZAP-it, i cili ka rreth 145 të punësuar. Auditori i Përgjithshëm dhe ZAP janë të pavarur dhe certifikon rreth 90 Pasqyra Vjetore Financiare çdo vit, ndërsa mund të ndër marr edhe forma tjera të auditimit.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhim të shëndoshë financiar në administratë publike. Ne do të kryejmë auditime cilësore në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit të sektorit publik dhe praktikat e mira evropiane. Ne do të ndërtojmë besim në shpenzimin e fondeve publike. Ne do të luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe palëve tjerë të interesit në rritjen e llogaridhënies publike.

Raportet e nxjerra nga ZAP promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien pasi që ato ofrojnë bazë për ti kërkuar llogari menaxherëve të çdo organizate buxhetore.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit dhe raportin mbi Pasqyrat Vjetore Financiare të Komunës së Pejës në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm Qerkin Morina, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti dhe opinionin i lëshuar janë rezultat i auditimit të kryer nën menaxhimin e Drejtorit të Auditimit, Faruk Rrahmani, i mbështetur nga, Faik Thaqi (Udhëheqës Ekipi), Enver Ramadani dhe Milosh Petroviq.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme	4
1 Fushëveprimi i auditimit dhe metodologjia	7
2 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm	8
3 Rekomandimet e vitit paraprak	12
4 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli	13
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP	29
Shtojca II: Rekomandimet e vitit paraprak.....	32

Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi ynë i pasqyrave vjetore financiare për Komunën e Pejës për vitin 2013 – i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Falënderojmë, Kryetarin e Komunës dhe ekipin e tij për ndihmën e tyre gjatë procesit të auditimit.

Ekzaminimi i pasqyrave vjetore financiare për vitin 2013 u ndërmor në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në Sektorin Publik të nxjerra nga INTOSAI. Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ne menduam se ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e ndërmarrë e reflekton qasjen e paraqitur në Memorandumin e Planifikimit të datës 29.10.2013.

Auditimi ynë është fokusuar në:

- Pajtueshmërinë me kornizën e raportimi dhe rreziqet domethënëse për Pasqyrat Vjetore Financiare të theksuara në Memon e Planifikimit të Auditimit;
- Veprimet e ndërmarra ndaj rekomandimeve tona për vitin 2012 dhe atyre të mëhershme; dhe
- Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin e Brendshëm të Komunës (duke përfshirë menaxhimin dhe ekzekutimin e buxhetit).

Niveli i punës së kryer nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm për të përfunduar auditimin për vitin 2013 pasqyron drejtpërsëdrejti cilësinë e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti.

Opinion

Shtojca I shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuar nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm.

Opinionin e Auditorit të Përgjithshëm është:

Sipas opinionit tonë pasqyrat vjetore financiare prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale.

Theksimi i çështjes

Gjithashtu, dëshirojmë të tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se informatat e shpalosur mbi pasuritë fikse nuk ishin të plota dhe të sakta, për shkakun se pasuritë e Qendrave të Mjekësisë Familjare nuk janë prezantuar në Pasqyra Vjetore Financiare të vitit 2013.

(SNISA 200: Opinion i Pamodifikuar me Theksim të Çështjes).

Konkluzioni i përgjithshëm

Bazuar në detajet e paraqitura në secilën pjesë të këtij raporti, konkluzioni ynë i përgjithshëm është se, menaxhmenti i komunës kishte dizajnuar sistemin e kontrollit të brendshëm, por këto kontrole nuk kishin funksionuar në disa fusha të rëndësishme të menaxhimit financiar. Ne në vazhdim po i paraqesim fushat në të cilat janë vërejtur mangësi:

- Mos prezantimi i plotë i pasurive jo financiare në pasqyrat vjetore financiare na shpie deri të konstatimi se ekzistojnë dobësi në kontrollet e zbatuara nga menaxhmenti për të konfirmuar plotësinë dhe saktësinë e pasurive;
- Një pjesë e rekomandimeve të vitit 2012 dhe të viteve të mëparshme nuk janë implementuar ende. Kjo do të rezultojë në kontrole të dobëta/vlerë të dobët për para;
- Dobësitë sistematike në procedurat e prokurimit, dhënien e subvencioneve dhe realizimin e të hyrave janë indikatorë se përmirësimet në fushat kyçe janë të ngadalshme;
- Edhe pse ne arritëm të merrnim siguri nga kontrollet efektive të menaxhmentit në disa fusha të pasqyrave, vlerësimi ynë për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin ka nxjerr në pah se në disa fusha të rëndësishme të veprimtarisë ekzistojnë dobësi domethënëse.
- Kjo veçanërisht ka ndodhur në prokurim, ku kontratat janë menaxhuar dobët, janë nënshkruar kontrata pa zotim të mjetëve, vonesa në ekzekutimin e punëve etj. Përkundër faktit se inkasimi i të hyrave ka qenë më i lartë në krahasim me planin, megjithatë vërehet se planifikimi nuk e ka përfshirë as vlerën e faturimeve brenda një viti dhe mungon një strategji e qartë për inkasimin e të arkëtueshmeve.

Rekomandimet kryesore të Auditorit të Përgjithshëm janë se, Kryetari duhet të:

- Sigurojë që në procesin e hartimit të Pasqyrave Vjetore Financiare për vitin 2014 të përfshihet formalisht edhe rishikimi nga menaxhmenti i draft pasqyrave me fokus të veçantë në fushat që konsiderohen me rrezik të lartë për gabime dhe/ose fushat ku gabimet janë identifikuar në vitet e mëparshme;
- Sigurojë që plani i veprimit, i rishikuar, të përcaktojë saktë afatet kohore për adresimin e rekomandimeve të bëra nga Auditori i Përgjithshëm, me stafin përgjegjës të identifikuar, duke u fokusuar fillimisht në fushat më të rëndësishme;
- Sigurojë vendosjen e një plani strategjik në lidhje me mbledhjen e të arkëtueshmeve dhe menaxhimin e këtij procesi. Një vlerësim paraprak duhet të bëhet bazuar në kompleksitetin e njohur të operacioneve ekzistuese dhe gjetjen e formës për rritjen e nivelit të mbledhjes së të hyrave vetanake.
- Kryejë një vlerësim të detajuar të procesit të Prokurimit dhe kontrollit për të kuptuar se pse dobësitë vazhdojnë të shfaqen dhe të identifikojë veprimet që duhen zbatuar për t'i adresuar këto dobësi; dhe
- Siguroj se shfrytëzimi i mjeteve nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve bëhet në pajtim me rregulloren e brendshme për subvencione dhe mjetet e ndara nga kjo kategori të arrijnë qëllimin e synuar.

Përgjigja nga Menaxhmenti - auditimi për 2013

Menaxhmenti është pajtuar me të gjitha gjetjet e auditimit dhe është zotuar se do t'i adresoj rekomandimet tona.

1 Fushëveprimi i auditimit dhe metodologjia

Është përgjegjësi e Komunës të përgatisë pasqyrat vjetore financiare (PVF) sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik (SNKSP) për “Raportimin Financiar në bazë të Kontabilitetit të Parasë së Gatshme” dhe kërkesave të tjera specifike. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm është përgjegjëse për kryerjen e auditimit të rregullsisë që përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare si dhe dhënien e opinionëve:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Ne kemi shqyrtuar shkallën deri në të cilën mund të mbështetemi në kontrollet menaxheriale gjatë përcaktimit të testimit të hollësishëm, të cilat janë të nevojshme për të siguruar nivelin e nevojshëm të dëshmive për të mbështetur opinionin e Auditorit të Përgjithshëm (AP) dhe fokusin e auditimit tonë. Pjesët e mëposhtme ofrojnë një përmbledhje më të detajuar të të gjeturave tona të auditimit me theks të veçantë në vëzhgimet dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit.

Për të qenë më i plotë, ne kemi përfshirë çështjet e identifikuara gjatë auditimit të ndërmjetëm aty ku ato kanë mbetur relevante. Të gjeturat tona janë definuar si:

Të prioritetit të lartë – Çështje të cilat mund të rezultojnë në dobësi materiale në kontrollin e brendshëm dhe ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme; dhe

Të prioritetit të mesëm - Çështje të cilat mund të mos rezultojnë në dobësi materiale, por ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme.

Procedurat tona kanë përfshirë një rishikim të kontrolleve të brendshme dhe sistemeve të kontabilitetit dhe procedurave, vetëm deri në atë masë që konsiderohet e nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen sikur përfaqësojnë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të të gjitha dobësive të cilat ekzistojnë, apo edhe të të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë funksionuar. Të gjeturat që konsiderohen si me prioritet të ulët, do t'i raportohen stafit të financave.

2 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

Konkluzioni i përgjithshëm

Rishikimi ynë i PVF shqyrton pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të regjistruar në pasqyrat financiare. Ne gjithashtu e marrim parasysh deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ (ZKA) dhe Zyrtari Kryesor Financiar (ZKF), kur draft PVF-të, të dorëzohen në Qeveri.

Deklarata në lidhje me prezantimin e PVF përfshin një numër të pohimeve për sa i përket pajtueshmërisë me kornizën raportuese dhe cilësinë e informacionit në kuadër të pasqyrave financiare. Disa deklaratë kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një auditim gjithëpërfshirës.

2.1 Opinioni i Auditimit

Opinion i Pamodifikuar¹ me Theksim të Çështjes

Sipas opinionit tonë pasqyrat vjetore financiare *prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale.*

Theksimi i çështjes

Gjithashtu, dëshirojmë të tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se informatat e shpalosur mbi pasuritë fikse nuk ishin të plota dhe të sakta, për shkakun se pasuritë e Qendrave të Mjekësisë Familjare nuk janë prezantuar në Pasqyrat Vjetore Financiare të vitit 2013.

(SNISA 200: Opinioni i Pamodifikuar me Theksim të Çështjes).

¹ Termi „opinion i pamodifikuar“ është ekuivalent me termin „opinion i pakualifikuar“ i përdorur në versionin paraprak të Raportit Vjetor. Terminologjia e re është në pajtim me standardet të reja të INTOSAI-t (SNISA 200). Për më tutje referohu në shtojcën I.

2.2 Rreziqet domethënëse në Pasqyrat Vjetore Financiare

Në Memon tonë të planifikimit të auditimit, janë identifikuar dy rreziqe domethënëse: atë për regjistrimin e të gjitha pasurive që kanë ndikim në PVF-të dhe shpalosjen e pagesave nga palët e treta.

Këto janë rreziqe të anomalive materiale, nga të cilat mund të rezultojë një opinion i modifikuar, përfshirë Theksimin e Çështjes.

Rreziku i anomalive materiale që ne kemi identifikuar në lidhje me regjistrimin dhe prezantimin e pasurive, ka ndodhur për shkak se menaxhmenti nuk kishte ndërmarrë veprime për të adresuar rreziqet e paraqitura. Kurse, rreziku nga pagesat e palëve të treta nuk kishte ndodhur.

Rreziku është identifikuar por nuk ka ndodhur

Rreziku i anomalive që ne kemi identifikuar në fazën e planifikimit në lidhje me shpalosjet dhe prezantimin e pagesave nga palët e treta nuk ka ndodhur. Projekte të ndryshme me vlerë të konsiderueshme janë duke u financuar brenda Komunës nga Ministria e Rinisë, Kulturës dhe Sporteve, Donatorët (USAID, IOM, EU). Menaxhmenti i Komunës e ka trajtuar drejt këtë rrezik dhe ka arritur që këto pagesa t'i prezantojë në PVF dhe të ofrojë shpalosje të duhura.

Përgjigja e Auditimit

Ne kemi shqyrtuar informatat e Komunës në lidhje me pagesat e palëve të treta dhe mund të konstatojmë se këto informata janë prezantuar në PVF.

Rreziku i identifikuar

Çështja 1 - Mungesa e regjistrimit të pasurive që janë në pronësi

Pasuritë në pronësi të Komunës nuk janë identifikuar dhe regjistruar në regjistrat e pasurive, duke rezultuar kështu në anomali materiale në shënimet e pasurive në PVF. Mos regjistrimi i të gjitha pasurive do të rezultojë në nënvlerësim material të vlerave të pasurive në PVF. Është vërtetuar se ky rrezik ekziston dhe komuna ende nuk ka arritur ta adresojë, ashtu siç kërkohet me rregullat e Thesarit.

Përgjigja e Auditimit

Në memon e auditimit të ndërmjetëm, ne i kemi dhënë këshilla menaxhmentit për veprimin që nevojitet të ndërmerren për të siguruar që shifra e pasurive në PVF të jetë e saktë. Megjithatë, rreziku i identifikuar është materializuar sepse menaxhmenti nuk ka arritur të

aplikojë përmirësimet e nevojshme në kontrollin e brendshëm dhe ne kemi konfirmuar që vlerat e pasurive të prezantuara në PVF janë materialisht të pasakta.

Në fazën finale të auditimit ne nuk mundëm të sigurojmë ndonjë raport të komisionit për inventarizimin e pasurive për të konfirmuar regjistrimin e plotë dhe me kohë të tërë pasurisë së komunës.

Rekomandimi 1 Prioritet i lartë - Kryetari duhet të identifikojë veprimin e duhur për t'i adresuar këto dobësi të kontrolleve në mënyrë që të mundësojë një prezantim të drejtë dhe të vërtetë të pasurive në vitin 2014

2.3 Pajtueshmëria me kërkesat për raportim në PVF

Përshkrimi

Pasqyrat vjetore financiare duhet të jenë në përputhje me kornizën e caktuar raportuese. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr. 03/2013;
- Kërkesat e Ligjit të Menaxhimit të Financave Publike nr. 03/L-048;
- PVF-të janë nënshkruar nga ZKA (Kryetari i Komunës) dhe ZKF;
- PVF-të janë përgatitur brenda kornizës kohore dhe janë dorëzuar në Ministri të Financave (MF) në gjuhën shqipe dhe serbe;
- PVF-të janë përgatitur në kopje fizike dhe elektronike; dhe
- Komuna ka përgatitur dhe ka dorëzuar raporte të rregullta tremujore te Asambleja Komonale dhe Ministri i MF gjatë vitit 2013.

Ne nuk kemi asnjë çështje për të ngritur në lidhje me këto, për shkak që çështjet e ngritura në memon tonë të auditimit të ndërmjetëm, në lidhje me kornizën raportuese janë adresuar nga Menaxhmenti.

2.4 Pajtueshmëria me kërkesat e tjera për raportim të jashtëm

Përshkrim

Përveç hartimit të PVF-ve, nga Komuna kërkohet të adresojë obligimet për raportim të jashtëm si në vijim:

- Kërkesat Buxhetore për financimin e projekteve kapitale;
- Raportet tremujore, duke përfshirë pasqyrat financiare nëntë mujore;
- Raporti i vetëvlerësimit sipas rregullave të MFK-së;
- Drafti dhe plani përfundimtar i prokurimit;
- Raportet mbi borxhet; dhe
- Plani i Veprimit për implementimin e rekomandimeve.

Ne nuk kemi çështje për të ngritur në lidhje me këto, pasi që komuna i ka përmbushur të gjitha obligimet për raportim të jashtëm. Po ashtu, këto kërkesa kanë qenë të cilësisë së mirë dhe në pajtim me afatet kohore që janë kërkuar.

3 Rekomandimet e vitit paraprak

Konkluzioni i përgjithshëm

Menaxhmenti i komunës kishte përgatitur planin e veprimit me kohë dhe ka bërë një progres në adresimin e rekomandimeve tona të dhëna në vitin e kaluar. Megjithatë, nevojitet që edhe rekomandimet tjera të zbatohen, në mënyrë që të evitohet përsëritja e dobësive të njëjta nga viti paraprak. Për një përshkrim të plotë të rekomandimeve dhe se si janë adresuar ato, shih Shtojcën II.

Përshkrimi

Raporti jonë i auditimit për PVF-të e vitit 2012 ka rezultuar me 20 rekomandime kryesore. Në fund të auditimit kemi vërejtur se tetë rekomandime janë adresuar plotësisht, katër janë në proces të adresimit, ndërsa tetë nuk janë adresuar fare.

Çështja 2- Adresimi i rekomandimeve nga viti paraprak – Prioritet i lartë

- | | |
|----------------------|--|
| E gjetura | Gati gjysma e rekomandimeve të vitit të kaluar kanë mbetur të pa adresuara dhe kjo e shton rrezikun që ato të përsëriten edhe në vitin 2013. Menaxhmenti nuk ka zbatuar ndonjë proces formal për të menaxhuar dhe monitoruar mënyrën e zbatimit të rekomandimeve të AP-së. |
| Rreziku | Dështimi në implementimin e rekomandimeve do të rezultojë në PVF-të jo të plota, vazhdim të menaxhimit të dobët, menaxhim të dobët të të hyrave, prokurimit dhe subvencioneve. Kjo do të rezultojë me shërbime jo cilësore/vlerë të dobët për para dhe jo efikasitet në aktivitete operative |
| Rekomandimi 2 | Kryetari i Komunës duhet të sigurojë që plani i veprimit, të rishikohet duke përcaktuar saktë afatet kohore për adresimin e rekomandimeve të bëra nga AP, me stafin përgjegjës të identifikuar, duke u fokusuar fillimisht në fushat më të rëndësishme. |

4 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli

Konkluzioni i përgjithshëm

Qasja jonë e auditimit është fokusuar në të kuptuarit dhe vlerësimin e veprimeve të ndërmarra nga menaxhmenti për të siguruar menaxhim të mirë financiar dhe kontroll efektiv. Për sisteme individuale financiare, ne kërkojmë të identifikojmë nivelin në të cilin operojnë kontrollet aktuale. Ky nivel, për shembull, mund të jetë aktiviteti monitorues i ndërmarrë nga menaxhmenti i lartë apo kontrollet operative të nivelit më të ulët.

Ne konsiderojmë se kontrollet janë të dizajnuara mirë, mirëpo nuk po zbatohen në praktikë dhe nuk po funksionojnë në mënyrë efektive. Kjo kërkon një vlerësim të strukturave, proceseve dhe linjave të llogaridhënies të prezantuara nga menaxhmenti, duke përfshirë rolin e ndërmarrë nga Auditimi i Brendshëm dhe Komiteti i Auditimit.

Ne kemi vërejtur se kontrollet mbi të hyrat nuk po zbatohen në mënyrë efektive. Kontrollet mbi një sërë fushash të shpenzimeve kërkojnë përmirësim të mëtejshëm në mënyrë që të parandalojë që komuna të ketë humbje financiare, vlerë të dobët për paranë dhe menaxhim jo efektiv të projektit. Fushat kryesore ku nevojiten më shumë përmirësime janë: prokurimi, të hyrat, subvencionet dhe menaxhimi i pasurisë.

4.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Përshkrimi

Në kemi shqyrtuar burimin e fondeve buxhetore për Komunën, shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike dhe të hyrat e inkasuara. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore - realizimi ndaj buxhetit (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ²	2013 Realizimi	2012 Realizimi	2011 Realizimi
Burimet e Fondeve:	19,652,317	20,952,752	20,263,384	18,970,438	18,738,853
Granti i Qeverisë -Buxheti	16,752,317	17,068,317	16,980,919	15,930,094	15,690,539
Të bartura nga viti paraprak ³ -	0	769,957	650,615	668,228	765,294
Të hyrat vetanake ⁴	2,900,000	2,900,000	2,456,879	2,121,449	1,880,030
Donacionet e brendshme	0	29,417	4,500	6,560	4,800
Donacionet e jashtme	0	185,061	170,469	244,107	398,190

Buxheti final, krahasuar me buxhetin fillestar, është më i lartë për 1,300,435€. Kjo rritje është rezultat i donacioneve vendore, të jashtme dhe të hyrave të bartura nga viti paraprak.

Buxheti është shpenzuar rreth 97% në nivel të përgjithshëm, aq sa ka qenë përqindja edhe vitin paraprak dhe mund të vlerësojmë një performancë të lartë të ekzekutimit të buxhetit në dy vitet e fundit nga Komuna.

² Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi që është e përshtatur vazhdimisht nga Ministria e Financave

³ Të hyrat vetanake të Komunave të pashpenzuara në vitin paraprak të bartura në vitin aktual.

⁴ Të hyrat e planifikuara dhe të inkasuara në vitin vijues..

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike- realizimi ndaj buxhetit (€)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2013 Realizimi	2012 Realizimi	2011 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	19,652,317	20,952,752	20,263,384	18,970,438	18,738,853
Pagat dhe Mëditjet	10,512,912	10,535,499	10,482,665	10,378,157	10,023,108
Mallrat dhe Shërbimet	2,343,763	2,739,363	2,705,611	2,686,923	2,009,956
Shërbimet komunale	591,914	601,914	597,009	557,083	500,349
Subvencionet dhe Transferet	350,000	601,007	599,233	473,692	328,432
Investimet Kapitale	5,853,728	6,474,970	5,878,865	4,874,583	5,877,008

Nga tabela 2. shihet, se te të gjitha kategoritë ekonomike ka pasur një efikasitet të lartë të shpenzimit krahasuar me ndarjet buxhetore.

Buxheti Final në krahasim me atë fillestar ka shënuar një rritje në vlerë prej 1,300,435€. Rritja ka ardhur nga rishikimi i buxhetit dhe rritje më e theksuar vërehet se ka pasur te investimet kapitale 621,242€, te mallrat e shërbimet 395,600€ dhe për subvencione e transfere 251,007€.

Çdo vit, të hyrat vetanake nuk shpenzohen si rezultat direkt i mos ekzekutimit të buxhetit duke pas parasysh se të hyrat vetanake janë burimi i fundit financiar i përdorur. Në vitin 2014 vlera e bartur e të hyrave ka qenë 665,510€.

Tabela 3. Të hyrat vetjake komunale të buxhetuara dhe të mbledhura në 2013 (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2013 Realizimi	2012 Realizimi	2011 Realizimi
Të hyrat vetanake	2,900,000	2,900,000	3,003,047	2,727,094	2,613,910

Siç shihet nga tabela 3. gjatë vitit 2013 të hyrat vetjake të planifikuara ishin 2,900,000€, ndërsa ishin inkasuar 3,003,047€. Trendi i inkasimit të të hyrave në tri vitet e fundit është pozitiv pasi që vërehet se kemi rritje të vazhdueshme.

4.2 Të hyrat (përfshirë të hyrat vetanake)

Përshkrimi

Komuna ka një trend pozitiv në inkasimin e të hyrave vetjake krahasuar me vitin paraprak dhe me planin e këtij viti. Janë vendosur kontrolle që kanë të bëjnë me mbledhjen dhe raportimin e të hyrave, megjithatë ekziston një nevojë për përmirësim të mëtejshëm në disa procese për ta mbështetur plotësinë e mbledhjes së të hyrave. Më poshtë po i paraqesim dobësitë që i kemi hasur te kategoria e të hyrave vetjake.

Çështja 3 – Tatim në Pronë – Prioritet i lartë

- E gjetura** Komuna nga tatimi në pronë për vitin 2013 kishte planifikuar të inkasoj 900,000€, ndërsa ka inkasuar 1,083,998€. Ne analizuam aspektin e faturimit për tatimin në pronë për të vlerësuar çështjen e planifikimit. Vlera e faturuar për vitin 2013 është 1,737,074€. Krahasuar vlerën e inkasuar me faturimet, del se komuna ka arritë të mbledhë 62% të shumës së faturuar për tatimin në pronë. Llogaritë e pa mbledhshme nga tatimi në pronë po rriten nga viti në vit dhe tani arrijnë shumën 8,016,674€.
- Rreziku** Politikat e dobëta të inkasimit kanë sjellë deri te rritja e llogarive të pa mbledhshme në 8,016,674€. Rritja e borxheve prej viti në vit nga tatimi në pronë ndikon që të hyrat e komunës të zvogëlohen dhe redukton mundësinë e realizimit të shumë projekteve me vetëfinancim.
- Rekomandimi 3** Kryetari duhet të sigurojë vendosjen e një plani strategjik në lidhje me mbledhjen e të arkëtueshmeve dhe menaxhimin e këtij procesi. Një vlerësim paraprak duhet të bëhet bazuar në kompleksitetin e njohur të operacioneve ekzistuese dhe gjetjen e formës për rritjen e nivelit të mbledhjes së tatimit në pronë.

Çështja 4 - Mos harmonizimi i të hyrave nga Departamentet komunale - Prioritet i mesëm

- E gjetura** Zyrtari i të hyrave bënë harmonizimin mujor, tremujor dhe nëntëmujor me Thesarin si dhe me drejtoritë përbrenda komunës që realizojnë të hyra. Mirëpo, ne kemi konstatuar se dy drejtori (drejtoria e arsimit dhe inspektionit) nuk bëjnë barazime mujore me zyrtarin kryesor për regjistrimin e të hyrave.
- Rreziku** Mos barazimet periodike ndikojnë që të dhënat për të hyrat e realizuara mund të raportohen në mënyrë të pasaktë dhe krejt kjo mund të reflektohet edhe në PVF.
- Rekomandimi 4** Për të siguruar saktësinë dhe plotësinë e të hyrave, Kryetari i komunës duhet të siguroj se në baza të rregullta bëhen barazimet e të hyrave nga departamentet komunale me zyrtarin e të hyrave.

Çështja 5 - Taksa e veprimtarisë së Bizneseve - Prioritet i mesëm

- E gjetura** Nga viti 2002, në kudër të komunës janë të regjistruara 7677 biznese, nga të cilat disa janë aktive dhe disa pasive. Komuna sipas ligjit për financa të pushtetit lokal ka inkasuar të hyra nga taksa për veprimtari afariste. Obligimet e bizneseve ndaj komunës deri në fund të vitit 2012 arrijnë shumën prej 6,360,180€.
- Kryetari i komunës me datë 17.12.2012 ka nxjerrë vendim për lirimin e bizneseve nga Taksa për veprimtari afariste për vitin 2013. Mirëpo, çështja e obligimeve të viteve të kaluara nuk është trajtuar në këtë vendim dhe vlera e borxheve ndaj komunës ka mbetur në nivelin e njëjtë.
- Rreziku** Nëse në vendimin e marrë nuk parashihet mënyra dhe afati kohor se si mendohet të inkasohen llogaritë e arkëtueshme, ekziston rreziku real që komuna vështirë do t'i inkasoj këto të arkëtueshme të grumbulluara.
- Rekomandimi 5** Kryetari duhet sa ma parë të planifikojë se si t'i trajtojë llogaritë e arkëtueshme nga taksa e veprimtarisë të grumbulluara gjatë viteve.

Çështja 6 - Të hyrat nga arsimi i mesëm - Prioritet i mesëm

- E gjetura** Komuna për vitin 2013 ka planifikuar të inkasojë të hyra nga Participimi në arsimin e mesëm, vlerën prej 70,000€, ndërsa ka realizuar 89,956€, pra është tejkaluar plani vjetor. Përkundër kontrolleve të vendosura mbi të hyrat e drejtorisë së arsimit, kemi gjetur se janë pranuar në arkë 24,780€. Vlerat e të hyrave të pranuar ishin mbi 10€ dhe sipas rregullave financiare ishte dashur të paguhen në llogarinë e komunës që ishte autorizuar nga Drejtori i Thesarit.
- Rreziku** Pranimi i parave kesh kur ekziston llogaria e hapur duke mos respektuar Rregullat e Thesarit, rrezikon që paratë të keqpërdoren ose humbin.
- Rekomandimi 6** Ne gjatë periudhës së ndërmjetme kemi këshilluar menaxhmentin që të ndërpres praktikën e pranimit të parave të gatshme mbi 10€ (jashtë llogarisë bankare). Në fazën finale jemi siguruar se veç ka filluar implementimi i këshillës së dhënë. Ne inkurajojmë menaxhmentin që të vazhdoj me praktikën e filluar.

Çështja 7 - Participimi i të hyrave nga Shëndetësia - Prioritet i mesëm

- E gjetura** Komuna për vitin 2013 ka planifikuar të inkasojë të hyra nga Participimi në shëndetësi, vlerën prej 110,000€, ndërsa ka realizuar 99,928€. Përkundër kontrolleve të vendosura mbi të hyrat e drejtorisë së shëndetësisë, kemi gjetur se janë pranuar në arkë vlera më të mëdha se 10€ të cilat është dashur të paguhen përmes llogarisë bankare të komunës që ishte autorizuar nga Drejtori i Thesarit.
- Rreziku** Pranimi i parave kesh kur veç ekziston llogaria e hapur bankare e komunës rrezikon, që paratë të keqpërdoren ose humbin.
- Rekomandimi 7** Kryetari duhet sa më parë të ndërmerr masa që vlerat mbi 10€ të paguhen në llogarinë bankare të komunës që është autorizuar nga Drejtori i Thesarit.

Çështja 8- Të hyrat nga objektet e dhëna me qira - Prioritet i mesëm

E gjetura Komuna për vitin 2013 ka planifikuar të inkasoj të hyra nga objektet e dhëna me qira vlerën prej 11,000€, ndërsa kishte inkasuar 6,300€. Në një rast komuna kishte dhënë me qira hapësirën komunale duke u bazuar në kontratën e datës 10.06.2009, për një vit me çmim mujor 500€. Komuna përkundër që nuk kishte inkasuar të hyrat nga qiraja, nuk e kishte ndërprerë kontratën me qiramarrësin.

Po ashtu, ka vonesa për një vit në inkasimin e qirave te rasti i dhënies së një lokali me qira me çmim 200€ në muaj.

Rreziku Mungesa e evidencave të plota për ngarkesa dhe pagesa për të gjithë qiramarrësit e objekteve mund të ketë si pasojë nën pagimin e qirasë dhe zvogëlimin e fondeve nga të hyrat.

Rekomandimi 8 Kryetari duhet të zbatoj një proces regjistrimi të të gjitha pronave dhe ngarkesave shoqëruese, i cili do të shqyrtohej në mënyrë të rregullt.

4.3 Shpenzimet

4.3.1 Prokurimi

Përshkrimi

Janë disa aspekte të procesit të prokurimit mbi të cilat kontrollet nuk janë aplikuar në mënyrë efektive. Proceset e prokurimit nga faza përgatitore e deri te përmbushja e kontratave nuk ishin menaxhuar plotësisht sipas rregullave të prokurimit.

Investimet kapitale të planifikuara për vitin 2013 ishin 5,384,728€, Me rishikim të buxhetit vlera e investimeve kapitale ishte rritur në 6,474,970€. Gjatë vitit 2013 janë shpenzuar 5,878,865€ ose 91%. Ne testuam gjithsej 31 mostra ose 60% të shpenzimeve kapitale që kapin vlerën prej 3,907,959€.

Auditimi ynë ka shpalosur mangësitë si në vijim:

Çështja 9 - Dobësitë sistematike në prokurim - Prioritet i lartë

E gjetura Te kontrata "Ndërtimi i zhveshtores në stadiumin futbollistik" në vlerë prej 39,964€ ishte paraparë me plan dinamik që punimet të përfundojnë për 41 ditë. Punimet janë kryer me një vonesë prej 55 ditëve dhe komuna nuk ka aplikuar penalet.

Te tenderi "Asfaltimi i rrugëve" është bërë shpërblimi i operatorit me kontratë pa i plotësuar kërkesat teknike dhe profesionale, siç janë kërkuar në dosjen e tenderit, si: diploma për menaxherin e projektit dhe lista e punëtorëve të lajmëruar në Administratën Tatimore të Kosovës.

Te katër kontrata "Renovimi dhe rindërtimi i Qendrës së Mjekësisë Familjare", "Ndërtimi i Ujësjiellit në fshatin Dugajevë", "Renovimi i Teatrit - Istref Begolli, faza e III" dhe ndërtimi i objektit për Ndërmarrje Lokale Publike "Ambienti" vlera e mjeteve të zotuar është më e vogël se sa vlera e kontratave.

Te dy kontrata "Asfaltimin e rrugës në fshatin Nobergjan" dhe "Ndërtimi i ndërmarrjes Lokale Publike Ambienti" fituesi i tenderit ka ofruar sigurimin e ekzekutimit të kontratës për 30 ditë më të shkurt se sa plani dinamik i punimeve.

Rreziku Lidhja e kontratave pa zotim të mjaftueshëm, mosrespektimi i kriterëve në përzgjedhjen e fituesit, vonesat në përmbushjen e kontratave, tregojnë mangësitë që e kishin përcjellë procesin e prokurimit. Të gjitha këto mangësi qojnë drejt rrezikut që Komuna të mos e arrijë vlerën për parane e shpenzua. Mangësitë e evidentuara dëmtojnë konkurrencën, transparencën e procesit dhe rrisin rrezikun e humbjeve financiare.

Rekomandimi 9 Kryetari duhet ta shqyrtojë pse kërkesat e prokurimit nuk janë adresuar në këto raste dhe të sigurojë se implementohen kontrole të shtuara, për të siguruar se situata të tilla nuk do të përsëriten.

Çështja 10 - Dobësi të kontrolleve në zbatimin e kontratave - Prioritet i Lartë

- E gjetura** Ne testuam përmbushjen e kontratës për servisimin e automjeteve të komunës e cila ishte lidhur me datë 06.09.2012 në vlerë prej 225,078€. Gjatë testimit të pagesave kemi vërejtur se për disa artikuj nuk ishin respektuar çmimet e kontratës gjatë faturimit dhe komuna i kishte pranuar dhe paguar ato. Rastet kur çmimet në faturë janë më të larta se në kontratë janë prezantuar në vijim:
- 1) Vaji i motorit me kontratë kishte çmimin 8€/litër ndërsa ishte faturuar me çmim 15€.
 - 2) Në katër raste ora e punës sipas kontratës ishte 30€ ndërsa ishte faturuar 34.80€ pasi ishte llogaritur edhe TVSh-ja.
 - 3) Në një rast tjetër Moduli i ndërrimit të motorit për veturën e tipit Opel Vectra në kontratë kishte çmimin 245€ për copë ndërsa ishte faturuar 1,100€ për copë.
- E gjetura** Kërkesat nga Komuna për furnizim më dru për ngrohje ishin 3,694.75m³ kurse Operatori Ekonomik (OE) fitues kishte ofruar vërtetimin nga Agjencia Pyjore e Kosovës vetëm për 720m³ dru për ngrohje. Pra sasia për të cilën OE posedonte leje ishte e pamjaftueshme me nevojat që kishte Komuna.
- E gjetura** Komuna për emetimin e seancave të asamblesë komunale në televizionin lokal TV Dukagjini ka paguar vlerën 3,000€. Me rastin e certifikimit të pagesës ka munguar dëshmia për të konfirmuar mbulimin televiziv të seancave. Nuk dihet pra nëse emetimi ka ndodhur sepse nuk ka ndonjë CD ose raport konfirmimi.
- E gjetura** Në një rast blerja e gypave për ujitje është dashur të jenë me dimension \varnothing ,300. Ne kemi vërejtur se janë pranuar gypa \varnothing , 250, kurse çmimi është faturuar dhe paguar, si për gypa \varnothing , 300. Pra çmimi i paguar nuk e reflekton kundërvlerën e asaj çka është pranuar.
- Rreziku** Dështimi i ndjekjes së procedurave të duhura të prokurimit dhe udhëzimet shoqëruese, ka rezultuar me pagesa potencialisht të parregullta dhe humbje financiare për komunën. Ekziston rreziku i mëtejme se është arritur vlerë e dobët për paranë e shpenzuar në këto kontrata.

Rekomandimi 10 Kryetari i Komunës duhet të siguroj një sistem efektiv të kontrollit në gjithë procesin e prokurimit deri te përmbushja e plotë e kontratave. Duhet ndërmerren veprime proaktive për parandalimin e devijimeve nga kushtet e kontratës si në pranimin e mallit ashtu edhe në pagesën e çmimeve për to.

Çështja 11 - Menaxhimi i automjeteve - Prioriteti i mesëm

E gjetura Sipas nenit 6 të UA nr.03/2008, çdo nëpunës që ka nevojë të shfrytëzojë veturën zyrtare. Së pari duhet të plotësoj formularin - kërkesën për shërbime të vozitjes, të nënshkruar nga eprori i tij. Ne kemi identifikuar se në Komunë, zyrtarët nuk e kishin plotësuar asnjë formular (kërkesë të nënshkruar nga eprori) për përdorimin e automjeteve zyrtare. Kërkesat për udhëtime zyrtare nuk janë plotësuar nga shfrytëzuesit e automjeteve.

Rreziku Kontrolli i brendshëm në procesin e menaxhimit të automjeteve është i pamjaftueshëm dhe rritë rrezikun për keqpërdorim të tyre. Mungesa e kërkesave për shfrytëzim të automjeteve shkakton mungesë të informatave lidhur me qëllimin e shfrytëzimit të automjeteve zyrtare.

Rekomandimi 11 Kryetari duhet sa ma parë të vendos kontrole efektive në këtë fushë, në mënyrë që automjetet të shfrytëzohen pasi të plotësohet dhe aprovohet kërkesa për shërbime të vozitjes.

4.3.2 Kompensimet (pagat dhe mëditjet)

Përshkrimi

Buxheti i planifikuar për kategorinë e pagave dhe mëditjeve ishte 10,534,294€, ndërsa shpenzimet për vitin 2013 ishin 10,482,665€, apo 99%.

Pagat dhe Mëditjet paguhen përmes një sistemi të centralizuar (payrollit). Kontrollat që operojnë në nivel lokal nga komuna kanë të bëjnë me a) kontrollin i pagesave çdo muaj duke i nënshkruar listën e pagave b) verifikimin e ndryshimeve të mundshme që mund të paraqiten përmes formularëve, c) rishikimin e buxhetit për këtë kategori dhe barazimet me thesarin.

Për këtë kategori testuam 54 mostra ku rishikuam pajtueshmërinë e listave të pagave me sistemin e payrollit në Ministrinë e Administratës Publike (MAP). Po ashtu, kemi shikuar nëse pozitat e zyrtarëve dhe koeficientet janë në pajtueshmëri me formën e sistemit të payrollit dhe listës së pagave.

Çështja 12 - Dosjet e personelit jo complete - Prioritet i mesëm

E gjetura Ne testuam dosjet e personelit për të verifikuar nëse ato janë complete. Nga 54 mostra, ne kemi vërejtur se 8 dosje që i përkasin departamentit të arsimit nuk ishin complete. Dosjeve ju mungonte kontrata e punës.

Rreziku Mungesa e kontratave të punës sjell deri te rreziku i pagesave të pagave për punëtorët që nuk janë në marrëdhënie pune, dhe si të tilla, pagesat janë të paligjshme.

Rekomandimi 12 Kryetari duhet të sigurojë që departamenti i burimeve njerëzore azhurnon në baza të rregullta të gjitha dosjet e personelit, përfshirë edhe kontratat e punës.

4.3.3 Subvencionet dhe Transferet

Përshkrimi

Buxheti Fillestar për kategorinë Subvencione dhe Transfere ishte 350,000€, ndërsa me rishikim të buxhetit ishte aprovuar vlera 601,007€. Shpenzimi për vitin 2013 ishte 599,233€. Kuvendi Komunal kishte aprovuar rregulloren për ndarjen e mjeteve për Transfere dhe Subvencione me 06 Mars 2013. Nga vlera e shpenzuar për subvencione ne kemi testuar 15 mostra me vlerë 87,388€. Dobësitë e gjetura prezantohen në vijim:

Çështja 13 - Vendime për subvencione pa fonde - Prioritet i lartë

E gjetura Kryetari i komunës kishte aprovuar vendime për subvencionime të ndryshme pa pasur mjete për pagesë. Obligimet e prezantuara në PVF-të e vitit 2013 janë 18,500€. Nga analiza jonë del se komuna ka marrë vendime për subvencionim pa mbulesë.

Rreziku Marrja e vendimeve në mungesë të buxhetit vjetor reflekton në dy rreziqe të ndryshme. Rreziku i parë është që vendimet të mos ekzekutohen fare në mungesë të fondeve dhe pala përfituese të mos i marr mjetet, dhe rreziku i dytë është që komuna hynë në obligime dhe kështu e rrezikon buxhetin e vitit të ardhshëm.

Rekomandimi 13 Kryetari duhet ta ndërpres këtë dukuri dhe në të ardhmen mos të marrë vendime pa pasur buxhet të aprovuar. Subvencioni duhet dhënë vetëm kur ka fonde dhe në pajtim me rregulloren për subvencione.

Çështja 14 - Subvencionimi i entiteteve publike - Prioritet i lartë

E gjetura

Komuna kishte subvencionuar entitete publike dhe jo publike. Në një rast komuna kishte subvencionuar meremetimin e xhamisë së qytetit me vlerë 16,739€. Paga është bërë në llogarinë e personit fizik, e jo në llogarinë e bashkësisë islame. Marrëveshja për subvencionim në nenin 3 parasheh që pas 30 ditëve të realizimit të projektit të ofrohet dokumentacioni original mbi shpenzimet e ndodhura. Komuna nuk kishte pranuar informata prapavajtëse se si janë shpenzuar mjetet.

Komuna ka subvencionuar Organizatën Joqeveritare (OJQ) "Top Lajm" me shumë 1,500€ për mbështetjen e projektit "Ferma Ime". Komuna nuk kishte pranuar informata prapavajtëse se si janë shpenzuar mjetet dhe a e kanë arritur objektivin e caktuar për çka janë destinuar.

Kryetari i Komunës ka subvencionuar me datë 17 Dhjetor 2012 Klubin futbollistik Arbreshët me shumën 5,215€ për shpalljen e sportistit të vitit 2012. Me marrëveshje ishte paraparë që 30 ditë pas përzgjedhjes të raportohet me shkrim për rezultatet e projektit që do të realizohet, gjë që nuk ka ndodhur. Të njëjtat çështje kanë ndodhur edhe me rastet e dhënies së subvencioneve për projektin teatror Rikardi III në vlerë 1,000€ dhe Shoqatën Pemëtaria me vlerë 1,000€.

Komuna ka subvencionuar OJQ "Need Unity" me vlerë 4,000€, pagesa ka ndodhur me datën 29.11.2013, si dhe vlera 7,000€ të paguara me datën 05.09.2013. Me marrëveshje sipas nenit 3 ishte paraparë që komunës së Pejës t'i raportohet me shkrim për mjetet e shpenzuara dhe aktivitetet e ndodhura. Pra, nuk kemi raportim se si i ka shpenzuar mjetet si dhe OJQ gjendet jashtë komunës së Pejës.

Me vendim të Kryetarit është subvencionuar Shtëpia Teatrorë Filmike AKT në Prishtinë me shumë 5,000€. Në marrëveshjen e nënshkruar nga kryetari i komunës nuk ka pasur plan të projektit, OJQ është jashtë komunës së Pejës si dhe në fund nuk është ofruar raporti i ekzekutimit të projektit.

Në një rast komuna ka subvencionuar një punëtoare të komunës me shumën 2,000€ për renovimin e banesës, ku me rregulloren e komunës një subvencionim i tillë nuk parashihet.

Në një rast tjetër komuna kishte subvencionuar ndërtimin e rrugës në fshatin Lybeniq me shumën 7,500€ pa ju ofruar ndonjë projekt.

Rreziku Dhënia e subvencioneve duke anashkaluar rregulloren e aprovuar në kuvend, mungesa e projekteve dhe pranimi të informatave prapavajtëse si dhe dhënia e subvencioneve jashtë territorit të komunës paraqet rrezik të shpenzimeve të parasë publike jashtë kontrolleve dhe vëjnë në pikëpyetje arritjen e objektivave.

Rekomandimi 14 Kryetari duhet të sigurohet se janë zbatuar marrëveshjet me përfituesit duke i obliguar ata të raportojnë në përputhje me marrëveshjen e nënshkruar. Të zbatohet rregullorja komunale për subvencione si dhe Komuna të sigurohet që subvencionet kanë arritur objektivat e përcaktuara.

4.4 Pasuritë dhe detyrimet

4.4.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Përshkrim

Komuna ka bërë një progres të lehtë në regjistrimin e pasurive në SIMFK, krahasuar me vitin paraprak. Në vitin 2013 sipas PVF ishin 318,891,670€, ndërsa në vitin 2012 kishte të regjistruar vlerën 316,318,000€.

Çështja 15 - Regjistrimi i pasurive - Prioritet i mesëm

E gjetura Komuna ende nuk ka një regjistër të plotë të pasurive të prezantuar në PVF. Ne testuam pasuritë në Qendrat e Mjekësisë Familjare dhe verifikuam se këto pasuri nuk janë prezantuar në PVF-të e vitit 2013.

Kryetari i Komunës kishte formuar me vonesë komisionin për inventarizimin e pasurive (10 shkurt 2014). Në kohën deri sa ne ishim në auditim, komisioni ende nuk kishte filluar me punë.

Rreziku Mos regjistrimi i plotë i të gjitha pasurive të cilat janë në pronësi të komunës, rritë rrezikun e nënvlerësimit të pasurive të komunës dhe paraqitjes jo të drejt të vlerës së pasurisë në pasqyrat vjetore financiare. Po ashtu kjo e rritë rrezikun e humbjeve, keqpërdorimit dhe përdorimit të pa autorizuar të tyre.

Rekomandimi 15 Kryetari duhet të siguroj veprime konkrete që mundësojnë regjistrimin e menjëhershëm të të gjitha pasurive në regjistrat përkatës në pajtim me kërkesat e UA dhe raportimin e saktë dhe të plotë të pasurive. Po ashtu duhet kryhet inventarizimi i pasurive në fund te vitit me qëllim që të vërtetohet ekzistenca fizike e gjithë pasurisë në ditën e inventarizimit.

4.4.2 Trajtimi i të arkëtueshmeve

Përshkrim

Komuna bazuar në Ligjin e Vetëqeverisjes Lokale inkason lloje të ndryshme të të hyrave vetanake. Në PVF 2013, Komuna ka prezantuar si llogari të arkëtueshme shumë prej 14,208,620€ dhe atë nga të arkëtueshmet e tatimit në pronë dhe taksa e veprimtarisë së bizneseve.

Çështja 16 - Rritja e të arkëtueshmeve - Prioritet i mesëm

E gjetura Komuna nuk kishte instaluar mekanizma efikas për inkasimin e llogarive të arkëtueshme nga tatimi në pronë dhe taksës së bizneseve. Në mbajtjen në nivel të lartë të llogarive të arkëtueshme ka ndikuar edhe heqja e taksës komunale të bizneseve.

Rreziku Joefikasiteti në inkasimin e të hyrave e rrit rrezikun që shumat e pa mbledhura nga tatimi në pronë dhe nga taksat komunale të barten nga viti në vit dhe të vjetërsohen. Rrezik tjetër është se qasja për mbledhjen e të arkëtueshmeve nuk është adekuate dhe si pasojë e kësaj kjo kategori e të arkëtueshmeve të rritet në vazhdimësi.

Rekomandimi 16 Kryetari duhet të ketë një çasje gjithëpërfshirëse në trajtimin e të hyrave, si në kuptimin e planifikimit ashtu edhe në vendosjen e mekanizmave efektiv për realizimin e parametrave të planifikuar. Menaxhmenti duhet të inicioj një proces rivlerësimi, ku të gjitha llogaritë do të analizohen në kuptimin e vjetërsisë, shumave domethënëse, mundësive reale për inkasim dhe ushtrimin e masave administrative.

4.5 Trajtimi i borxheve

Përshkrim

Pasqyra e detyrimeve të papaguara në fund të vitit 2013 ishte 560,075€. Këto detyrime janë bartur për t'u paguar në vitin 2014. Shumën më të madhe të këtyre obligimeve e përbëjnë shpenzimet nga mallrat dhe shërbimet 378,729€ si dhe shpenzimet komunale 110,971€.

Çështja 17 - Hyrja në detyrime përtej fondeve - Prioritet i lartë

E gjetura Obligimet e pa paguara të komunës të shpalosura në PVF-të 2013 janë 560,075€. Vlera e obligimeve për subvencione në bazë të vendimeve ishte më e madhe se sa që ishte prezantuar në PVF, për shkak që janë marrë vendime në mungesë të fondeve. Buxheti për shpenzime komunale ishte 601,914€, shpenzimi për këtë kategori ishte 597,008€ si dhe obligimet e pa paguara për vitin 2013 ishin 110,971€ që na sjell deri të konkludimi se komuna ka tejkalluar buxhetin e aprovuar.

Rreziku Marrja e vendimeve për dhënien e subvencioneve duke tejkalluar buxhetin e aprovuar në kuvend si dhe në mungesë të mjeteve financiare rrit rrezikun e mos pagesës së tyre si dhe humbjen e vlefshmërisë së vendimeve të marra nga Kryetari i Komunës.

Rekomandimi 17 Kryetari duhet të siguroj që komuna të mos futet në obligime duke e tejkalluar buxhetin dhe duke e rrezikuar buxhetin e vitit të ardhshëm.

4.6 Sistemi i auditimit të brendshëm

Përshkrimi

Njësia e Auditimit të brendshëm (NJAB) ka tre auditor ku njëri nga ta është edhe drejtor njësie. Ai kishte përgatitë planin vjetor të auditimit për vitin 2013 i cili është aprovuar nga menaxhmenti i Komunës. NJAB, për vitin 2013 kishte planifikuar të kryej 12 auditime.

Gjatë vitit 2013 ishin kryer 10 auditime. Ne nuk kemi mundur të mbështetemi në punën e auditimit të brendshëm për shkak që gjysma e auditimeve të kryera kishin të bënin me vitin e kaluar dhe objektiva jonë e auditimit ka të bëjë me vitin 2013.

Po ashtu, NJAB kishte përgatitë raporte tre mujore të cilat i kishte dërguar edhe në Njësinë Qëndrore Harmonizuese në Ministrinë e Financave.

Komuna ka të formuar komitetin e auditimit i cili ka mbajtur katër takime gjatë vitit, ku janë shqyrtuar raportet e auditimit të brendshëm dhe puna e kësaj njësie.

Çështja 18 - Auditimi i brendshëm - Prioritet i mesëm

E gjetura Ligji i Auditimit të Brendshëm parasheh që deri me 31 tetor të çdo viti kalendarik, drejtori i auditimit të brendshëm planifikon auditimin për vitin e ardhshëm kalendarik, gjë që edhe është bërë. Por, ne kemi vërejtur se gjysma e auditimeve të kryera deri më tani kishin si fokus vitin 2012.

Rreziku Ndjekja e çështjeve nga auditimi i brendshëm pasi ngjarjet të kenë ndodhur, nuk i shton vlerën e duhur mbarëvajtjes së aktiviteteve operative dhe funksionimit të kontrolleve të duhura. Auditimi i brendshëm duhet të veproj si një mekanizëm parandalues i gabimeve dhe parregullsive.

Rekomandimi 18 Kryetari duhet të sigurojë se plani i auditimit për njësinë e auditimit të brendshëm të përfshij proceset/aktivitetet e vitit aktual në mënyrë që të ndihmoj menaxhmentin në marrjen e vendimeve me kohë dhe të parandalojë parregullsitë dhe gabimet eventuale.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë anomali materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë anomali materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornizë për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinion në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë anomali materiale. Auditorët mund të japin tre lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- Natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë anomali materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë anomali materiale; dhe
- Gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se anomali, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk përhapen në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare mund të jenë materiale por nuk përhapen.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se anomali, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe përhapen në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare mund të jenë edhe materiale edhe të përhapen. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 170519 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban anomali materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i Theksimit të Çështjes duhet:

- Të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- Të ketë titullin 'Theksim i Çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- Të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen;
- Të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Rekomandimet e vitit paraprak

Komponenti i Auditimit	Rekomandimet e dhëna	Rekomandimet plotësisht të adresuara	Rekomandimet pjesërisht të adresuara	Rekomandimet e pa adresuara
2.1 Pasqyrat vjetore financiare	Rekomandojmë Kryetarin e Komunës që me rastin e përgatitjes së PVF duhet merret parasysh edhe obligimi ligjor që PVF të përgatiten edhe në gjuhën serbe.	Po		
2.2 Cilësia dhe saktësia e informatave të prezantuara në pasqyrat vjetore financiare	Kryetari i Komunës duhet të sigurojë se plani sistematik i përpilimit të pasqyrave financiare inkorporon kërkesën për të përfshirë tërë vlerën e pasurive. Kryetari ka nevojë të monitoroj zbatimin e kësaj kërkesë. Sugjerojmë që në të ardhmen e afërt, komisioni i formuar të vazhdojë vlerësimin e plotë të të gjithë pasurisë fikse që është në pronësi të Komunës.			Jo
3. Rekomandimet e vitit paraprak	Kryetari i Komunës duhet të sigurojë që plani i veprimit i rishikuar në mënyrë të qartë përcakton një afat kohor për adresimin e rekomandimeve me anëtarët e stafit llogaridhënës, të identifikuar - me fokus fillestar në ato të një rëndësie të madhe.	Po		
4.4 Të hyrat (përfshirë të hyrat vetjake)	Kryetari i Komunës duhet të sigurojë se një zgjidhje e duhur e softuerit do të zhvillohet dhe testohet brenda vitit aktual financiar në mënyrë që të përmbushen kërkesat e specifikuar të menaxhmentit.		Pjesërisht	
4.4.4 Shfrytëzimi i tokës pa kriterë	Kryetari i Komunës duhet zbatoj një proces regjistrimi të të gjitha pronave të dhëna në shfrytëzim dhe ngarkesave shoqëruese, i cili do të shqyrtohet të paktën çdo gjashtë muaj nga një zyrtar i lartë. Duhet përcaktuar kriteret dhe të zbatohet konkurrenca.		Pjesërisht	

4.4.5 Ndërtimet pa leje	Kryetari i Komunës duhet të siguroj se drejtoria e Inspektoratit aplikon të gjitha kontrollet/mekanizmat për denoncimin e të gjithë investitorëve të cilët nuk i përmbahen kriterëve për pajisje me leje ndërtimi, si dhe respekton vendimet që nxjerrë menaxhmenti.	Po		
4.4.6 Inkasim i dobët për taksë për ushtrimin e veprimtarisë	Kryetari i Komunës duhet të siguroj se kontrollet që kanë të bëjnë me inkasimin e këtyre të hyrave duhet të vendosen, në mënyrë që të sigurohet se diferencat në mes planit dhe inkasimeve janë reduktuar. Identifikimi i bizneseve që operojnë dhe atyre që nuk janë aktive, duhet të monitorohet në vazhdimësi.	Po		
4.4.7 Evidenca jo të plota për taksën për regjistrimin e automjeteve	Kryetari i Komunës duhet të siguroj se zyrtari përgjegjës bën regjistrimin e plotë dhe të saktë të taksës për regjistrimin e automjeteve në mënyrë që të jetë në gjendje në çfarëdo kohe të jap raporte të besueshme.	Po		
4.4.8 Pranimi pagesave mbi 10€ nga arsimi joformal	Kryetari i Komunës duhet të sigurojë kontrollet lidhur me inkasimin e të hyrave, në mënyrë që të sigurohet se diferencat në mes të faturave dhe dëftesë pagesave në Thesar janë identifikuar me kohë dhe procedurat janë aplikuar për t'i gjetur shumat e papaguara. Inkasimet në shumë mbi 10€ duhet të procesohen vetëm përmes llogarisë bankare.			Jo ende inkasohen mbi 10€ në shkolla dhe shëndetsi
4.5.1 Prokurimi - Aneks kontratë pa justifikim të duhur	Kryetari i Komunës duhet të siguroj se shërbimi teknik ka përgatitë parallogarinë dhe paramasën me të gjitha analizat e duhura, për t'iu shmangur nevojës për punime shtesë.	Po		
4.5.1 Prokurimi - Dritaret me çmim prej 120€ paguhen me çmim prej 230€	Kryetari i Komunës duhet të hulumtoj në hollësi arsyet për këto mospërputhje si dhe të aplikoj masat e llogaridhënies për personat e involvuar.	Po		

4.5.1 Prokurimi - Kontrata pa zotime të mjaftueshme dhe mos konsistencë pagesash	Kryetari i Komunës duhet të siguroj që të mos hyjë në kontrata pa fonde të sigurta. Organi mbikëqyrës duhet të vëzhgoj dinamikën e ndërtimit brenda kantierit dhe jo nga zyret, si dhe pagesat të certifikohen vetëm pasi punimet janë kryer. Një raport më i qartë në mes shërbimeve teknike dhe të financave duhet vendosur.			Jo në shumë kontrata ka mungesë zotimesh
4.5.1 Prokurimi - Pagesa e faturës pa përshkrim të punëve	Kryetari i Komunës duhet të siguroj se faturat e paguara janë në përputhje të plotë me kushtet e kontratës dhe shërbimet e kryera/pranuara.		Pjesërisht	
4.5.1 Prokurimi - Paguhen servisime pa aprovim të drejtorit	Kryetari i Komunës duhet të siguroj se çdo kërkesë shqyrtohet dhe aprovohet nga nivelet përgjegjëse menaxheriale, për të zvogëluar mundësinë për manipulim me paranë publike.			Jo
4.5.2 Shpenzimet tjera - Pa arsyeshmëri e avanseve për udhëtime zyrtare	Kryetari i Komunës duhet të rishikoj rastet e mësipërme dhe të siguroj se paratë e shpenzuara t'i kthehen buxhetit, si dhe praktikatat e tilla të mos përsëriten.	Po		
4.5.3 Kompensimet (pagat dhe mëditjet)	Kryetari i Komunës duhet të sigurojë një shqyrtim sistematik i Dosjeve të Personelit duhet të ndërmerret, për të siguruar se i tërë dokumentacioni i nevojshëm është përfshirë, brenda një periudhe të specifikuar kohore.			Jo
4.5.4 Subvencionet dhe Transferet	Kryetari i Komunës duhet të vendos kontrolle që komisioni për vlerësimin e aplikueseve është i paanshëm, i drejtë dhe transparent në përzgjedhjen e përfituesve.		Pjesërisht	

4.6 Pasuritë	Kryetari i Komunës duhet të siguroj se regjistrimi dhe azhurnimi i regjistrit të pasurive do të bëhet në të gjithë sektorët e komunës.			Jo
4.6.2 Trajtimi i të arkëtueshmëve	Kryetari i Komunës duhet të përgatis një Plan veprimi ku do të propozohen udhëzime të qarta për të gjithë sektorët relevant të komunës për ngritjen e inkasimeve. Plani duhet të përmbaj prioritete, ndarjen e borxheve sipas vjetërsisë, afatet kohore për veprimet që duhet të merren, arsyet e mospagesës, mekanizmat e duhur dhe diskutimin e arritjeve, së paku dy herë në vit.			Jo
4.7 Trajtimi i borxheve	Kryetari i Komunës duhet të siguroj një planifikim të hollësishëm dhe real të buxhetit dhe se shfrytëzimi i fondeve bëhet në bazë të një plani të qartë të rrjedhës së parasë, duke mos tejkaluar në asnjë rast fondet e alokuara sipas kategorive ekonomike.	Po		
5 Sistemi i auditimit të brendshëm	Kryetari i Komunës duhet të sigurojë se një Plan veprimi duhet të zbatohet, duke i konfirmuar zyrtarët përgjegjës dhe kohën për kryerjen e veprimeve. Auditimi brendshëm duhet të ketë në fokus të veçant aktivitetet në vitin aktual, me efekt parandalues të veprimi. Gjithashtu, në një të ardhme të afërt, rekomandohet edhe formimi i Komitetit të auditimit			Jo